



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:102744
Datë: 06.06.2024
Numri i dokumentit: 05792479

KPPP.nr. 683/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër debitorit D.P.T. “Emiri” dhe me seli në Mitrovicë, me bazë juridike borxh në bazë të titullit ekzekutiv të lejuar sipas aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit CP.nr. 334/2013 të datës 19.03.2018 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 06.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet **JO KOMPETENTE NË PIKËPAMJE LËNDORE** për të vendosur në çështjen përmbartimore të lejuar sipas aktvendimit CP.nr. 334/2013 të datës 19.03.2018 në mes të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë kundër debitorit D.P.T. “Emiri” dhe me seli në Mitrovicë.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore Mitrovicë – Departamentit të Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Në këtë çështje përmbartimore, Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, përmes aktvendimit CP.nr. 334/2013 të datës 19.03.2018, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit D.P.T. “Emiri” për ekzekutimin e borxhit në

bazë të titullit ekzekutiv aktvendim i Doganës së Kosovës Knr. 04.2.3.1/815 të datës 05.01.2011, në shumën e përgjithshme prej 500.00 EUR.

Gjykata e lartcekur, me aktvendimin CP.nr. 334/2013 të datës 19.07.2022, ka pezulluar procedurën në këtë çështje përmbarimore, kjo për shkak të pamundësisë së dërgimit të propozimit për përmbarim së bashku me aktvendimin për lejimin e përmbarimit në adresën debitorit.

Ndërsa, me aktvendimin CP.nr. 334/2013 të datës 04.10.2023, gjykata tutje ka përfunduar në tërësi procedurën në këtë çështje përmbarimore me arsyetimin se kreditori Dogana e Kosovës, brenda afatit prej 6 muajsh nuk ka paraqitur informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr. 250/2024 të datës 12.04.2024, ka aprovuar ankesën e këtui kreditorit Dogana e Kosovës dhe ka anuluar aktvendimin CP.nr. 334/2013 të datës 04.10.2023 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, ndërsa lëndën, e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa mjetet juridike në procedure përmbarimore, konform Ligjit nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67 sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe*

përsëritja e procedurës në procedurën përmbare. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbareueshëm për përmbareimin me dhunë.”

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbare të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, pasi që lidhur me lëndën në fjalë, pala debitore ende nuk është njoftuar dhe nuk ka pranuar propozimin për përmbare dhe aktvendimin për lejimin e përmbareimit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë si organ përmbareues. Rrjedhimisht, vetëm atëherë kur krijohet gjyqvarësia me palën debitore, dhe eventualisht në rast të ushtrimit të mjetit juridik të prapësimit nga kjo e fundit, lind kompetenca lëndore e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së parë për trajtimin e mjetit juridik në këtë çështje kontestimore.

Andaj, meqenëse Gjykata Komerciale e Kosovës nuk vepron si organ përmbareues por ka tagër vetëm shqyrtimin e mjeteve juridike në procedurë përmbare, ndërsa në anën tjetër, është obligim organit përmbareues, në këtë rast Gjykatës Themelore në Mitrovicë që të zhvilloj komunikimin me palën debitore për ta njoftuar lidhur me procedurën përmbare të iniciuar ndaj tij, rezulton se pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, është gjykatë kompetente për zbatimin e përmbareimit në këtë çështje përmbare, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Gjykata pati parasysh faktin se me aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr. 250/2024 të datës 12.04.2024 të lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, lënda në fjalë është kthyer në rivendosje pranë kësaj gjykate, por që Dhomat të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, janë të lidhura me vendimin për kompetencën lëndore vetëm në rastet kur lënda është transferuar pranë kësaj gjykate nga gjykata e cila do ishte kompetente për trajtimin e konfliktit të kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, kjo në kuptim të nenit 24 par.3 të LPK-së i cili përcakton që *“vendimi i gjykatës së shkallës së dytë mbi in kompetencën lëndore të gjykatës së shkallës së parë e obligon çdo gjykatë të cilës i dërgohet më vonë lënda e njëjtë, në qoftë se gjykata e shkallës së dytë është kompetente për zgjidhjen e konfliktit lidhur me kompetencën midis këtyre dy gjykatave”*.

Andaj, meqenëse konfliktin mes gjykatave të llojit të ndryshëm e shqyrton Gjykata Supreme e Kosovës, rezulton se Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, nuk është e lidhur me aktvendimin mbi kompetencën lëndore të caktuar nga Dhoma e Shkallës së Dytë të

kësaj gjykate, përderisa kjo gjykatë nuk vendos edhe për konfliktin e kompetencës mes Gjykatës Komerciale të Kosovës dhe Gjykatës Themelore në Prizren.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 5 dhe nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 683/24, datë 06.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.